



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:249733
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05619418

KE.nr. 244/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të Paditësit/Kundërtëpaditurit “Tema Group” Sh.P.K., me numër të biznesit 70613387 dhe seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit A.T., avokat nga Prishtina, ndaj të Paditurës/Kundërtëpaditëses N.T.Sh. “Naki Trade” me numër të biznesit 70420691 dhe seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.M., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti sipas padisë dorëzimi i paluajtshmërisë në posedim dhe pronësi dhe objekt kontesti sipas kundërtëpadisë kompensimi i dëmit, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës me datën 25.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në çështjen juridike mes Paditësit/Kundërtëpaditurit “Tema Group” Sh.P.K., dhe të Paditurit/Kundërtëpaditësit N.T.Sh. “Naki Trade”, me objekt kontesti sipas padisë dorëzimi i paluajtshmërisë në posedim dhe pronësi dhe objekt kontesti sipas kundërtëpadisë kompensimi i dëmit.
- II. Pas plotfuqishmërisë se këtij aktvendimi lënda se bashku me shkresat e saj i dërgohet Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 26.08.2016, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike ka paraqitur padi ndaj të paditurës N.T.SH. “Naki Trade”, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t’ia dorëzoj në posedim dhe pronësi sipërfaqen e palujatshmërisë sipas deklaratës mbi bashkëndërtimin e objektit, dhe kompensimin e dëmit në shumën prej EUR 650,000.00.

Në të njejtën procedurë, e paditura ka paraqitur kundërpadi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet Paditësi/Kundëripadituri që të Paditurës/Kundërpaditëses t’ia kompensoj dëmin për shkak të mos përmbushjes së kontratës, ndërsa gjykata me aktvendimin procedural të nxjerrë në seancën e datës 21.01.2021 ka lejuar paraqitjen e kundërpadisë në të njejtën procedurë.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015, për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë është transferuar pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale sipas kompetencës lëndore të kësaj gjykate.

Tani, gjykata pas shqyrtimit paraprak të shkresave të lëndës, në përputhje me nenin 17 dhe 19 të LPK-së, vlerësoi kompetencën lëndore në këtë çështje juridike dhe gjeti se Departamenti për Çështje Ekonomike pranë Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për trajtimin e kësaj çështje kontestimore.

Sipas nenit 13, paragrafi 1, pika 1.7. të Ligjit për Gjykatën Komerciale (Ligji nr. 08/L-15) përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë ndër tjerash edhe për *“kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore, siç është e paraparë me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare”*, ndërsa, me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.6, 1.7, 1.8, 1.10 dhe 1.13 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti i Përgjithshëm”*.

Në kuptim të dispozitave të lartcekura dhe nisur nga fakti se objekt i padisë së Paditësit/Kundërtëpaditurit është dorëzimi në posedim dhe pronësi i palujatshmërisë sipas deklaratës mbi bashkëndërtimin e objektit dhe kompensimi i dëmit, ndërsa paraqitja e kundërpadisë nga e Paditura/Kundërpaditësjas është lejuar të zhvillohet në të njejtën procedurë,

në kuptim të dispozitave nga neni 13, pika 1.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, gjykata vlerëson se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështje është Departamenti i Përgjithshëm i Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës dhe jo Departamenti për Çështje Ekonomike i kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 dhe 19 lidhur me nenin 387.1 pika (u) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 244/22, datë 25.04.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.